



Komisioni Komunal për dhënien në shfrytëzim

të pronës së paluajtshme Komunale

Nr.06/2017

Dt.11.09.2017

Në bazë të nenit 5 dhe 8 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 4, 7 dhe 8 të Rregullores QRK NR.23/2013 Për përcaktimin e procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të pronës së Paluajtshme të Komunës, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë 01Nr.125/2014 të dt.28.05.2017 si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë,nr.01Nr.14/16 të dt.28.01.2016, Komuna e Vushtrrisë shpallë këtë:

**NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUJTSHME KOMUNALE**

NENI 1: EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri i AK Komuna Vushtrri Komisioni Komunal për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale	Personi kontakt: Bedri Dobra tel.044/212-646 Ilirjana Azemi tel.044/347-419
Adresa SHESHI ‘‘HASAN PRISHTINA’’	Kodi postar 42000
QYTETI Vushtrri	Komuna Vushtrri
E-mail pronatkomunale@gmail.com	

NENI 2: LËNDA E ANKANDIT

Komuna e Vushtrrisë-**Komisioni Komunal për dhënie në shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale**, në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë,nr.01Nr.14/16 të dt.28.01.2016, ka përcaktuar dhënien në shfrytëzim afatshkurtër me kompensim të pronës së paluajtshme komunale përmes ankandit publik procedurës së ofertave të mbyllura.

Dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme komunale, si në vijim:

*Lokacioni i cili gjendet në ngastrën kadastrale P-70202016-00256-0 e cila përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 36.00m², ku përfshihen 4 hapësira me nga 9m², Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e komunës së Vushtrrisë, i cili gjendet në rrugën ‘‘Tirana’’ .

*Lokacioni i cili gjendet në ngastrën kadastrale nr.P-70202016-01102-0, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e komunës, i cili përfshin një sipërfaqe prej ndërtuese prej 51.00m², ku përfshihen pesë hapësira, tri nga 9 m² dhe dy nga 12m² i cili gjendet në rrugën ‘‘Kruja’’ .

*Lokacioni i cili gjendet në ngastrën kadastrale P-70202016-00001-1 e cila përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 40.88m², 25.2m², 28.0m², 28.0m², 20.72m², 31.92m² dhe 48.84m², Zona Kadastrale Vushtrri , pronë e komunës së Vushtrrisë, i cili gjendet në rrugën “Tahir Sinani” .

*Lokali i cili gjendet në ngastrën kadastrale nr.P-70202016-00648-0, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e komunës, i cili përfshin një sipërfaqe prej ndërtuese prej 32.0m², i cili gjendet në sheshin “Hasan Prishtina” .

*Lokali i cili gjendet në ngastrën kadastrale nr.P-70202016-02254-2, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e komunës, i cili përfshin një sipërfaqe prej ndërtuese prej 11.0m², i cili gjendet në rrugën “Jeton Tërrstena” .

*Lokacioni i cili gjendet në ngastrën kadastrale P-70202016-02384-0 e cila përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 7.0m² dhe 6.0m², Zona Kadastrale Vushtrri , pronë e komunës së Vushtrrisë, të cilat gjenden në rrugën “Gjergj Kastrioti-SKENDERBEU” Vushtrri.

*Lokacioni i cili gjendet në ngastrën kadastrale P-70202016-1108-19 e cila përfshin lokalet me sipërfaqe ndërtuese prej 8.61m², 8.61m², 7.38m², 9.94m² dhe 4.0m², Zona Kadastrale Vushtrri , pronë e komunës së Vushtrrisë, të cilat gjenden në Sheshin “Adem Jashari”.

*Lokali i cili gjendet në ngastrën kadastrale nr.P-70202016-00270-0, Zona Kadastrale Shtitaricë, pronë e komunës, i cili përfshin një sipërfaqe prej ndërtuese prej 12.0m², i cili gjendet në fshatin Shtitaricë Komuna Vushtrri.

*Lokacioni i cili gjendet në ngastrën kadastrale P-70202016-00520-0 e cila përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 15.0m² , Zona Kadastrale Vushtrri , pronë e komunës së Vushtrrisë, e cila gjendet në rrugën “Dëshmoret e Kombit” Vushtrri.

*Lokacioni i cili gjendet në ngastrën kadastrale P-70202016-00420-2 e cila përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 15.0m² , Zona Kadastrale Vushtrri , pronë e komunës së Vushtrrisë, e cila gjendet në rrugën “Dëshmoret e Kombit” Vushtrri.

3.Të drejt pjesëmarrjes kanë personat fizik dhe personat juridik;

4.Kriteri i dhënies së kontratës :Oferta e përgjithshme me çmimin më të lart;

5.Çmimi fillestar për m² në muaj është 2.00€.

6.Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës për lokacionet që gjinden në rrugën “Tirana” dhe “ Kruja” afati është 5 vite me mundësi vazhdimi edhe për 5 vite tjera ndërsa lokacionet tjera dhe lokalet afati i dhënies në shfrytëzim është 15 vite.

NENI 3: AFATET DHE PROCEDURAT

1. Ankandi Publik është i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes së Ankandit;
2. Afati kohorë i fundit për tërheqjen e dokumentacionit të ankandit është data: 09.10.2017 ora 15:00
3. Afati kohorë për dorëzim-pranimin e aplikacioneve është data: 10.10.2017 , më së largu deri në ora 14:00 vendi Komuna e Vushtrrisë , zyra e pranimit-arkiva,zyra nr.1 kati përdhese.
4. Ofertata duhet dorëzuar të mbyllura; tërheqja e aplikacioneve mund të bëhet në formë fizike dhe elektronike nëpërmes E-mail:pronatkomunale@gmail.com.
5. Takimi për hapjen e aplikacioneve bëhet me datën:10.10.2017 , vendi Salla e Kuvendit Komunal – Vushtrri.
6. Informacionet shtesë mund ti kërkoni te z.Bedri Dobra ,Drejtoria e Kadastrit Gjeodezisë dhe Pronës dhe znj.Ilirjana Azemi ,Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

NENI 4:ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë te Komisioni për Ankesa pran Komunës së Vushtrrisë, sipas dispozitave të nenit 9 pika 3 të Ligjit Nr. 04/L-144, Ligji për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale.